21. Kartelë Model 2 nr. 7086, në ngarkim të M. Gj. Gj., me 2 (dy) fletë. Kartela i përket fondit Dega IV.
22. Kartelë Model 2 nr. 711, në ngarkim të N. P. Gj., me 2 (dy) fletë. Kartela i përket fondit Dega IV.
23. Kartelë Model 2 nr. 13841/23325, në ngarkim të A. J. I., me 2 (dy) fletë. Kartela i përket fondit Dega IV.
24. Kartelë Model 2 nr. 2345, në ngarkim të M. Q. M., me 2 (dy) fletë. Kartela i përket fondit Dega IV.
25. Dosje Personale dhe Pune nr. 1639, në ngarkim të N. P. M., konkretisht nga dosja e punës raport i datës 19.08.1979 me 2 (dy) fletë, raport i datës 18.09.1979 me 2 (dy) fletë, raport i datës 05.11.1979 me 2 (dy) fletë, raport i datës 20.01.1980 me 2 (dy) fletë, raport i datës 06.01.1981 me 2 (dy) fletë, raport i datës 15.01.1981 me 2 (dy) fletë, raport i datës 24.01.1981 me 2 (dy) fletë, raport i datës 05.02.1981 me 2 (dy) fletë, raport i datës 25.02.1981 me 3 (tri) fletë, raport i datës 24.05.1981 me 3 (tri) fletë dhe raport i datës 15.10.1981 me 2 (dy) fletë. Në total janë 25 (njëzet e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dokumenteve është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Mirditë.

26. Kartelë Model 2 nr. 1526, në ngarkim të D. P. R., me 2 (dy) fletë. Kartela i përket fondit Dega IV.
27. Kartelë Model 2 nr. 1656, në ngarkim të D. P. N., me 2 (dy) fletë. Kartela i përket fondit Dega IV.
28. Kartelë Model 2 nr. 480, në ngarkim të T. S. M., me 2 (dy) fletë. Kartela i përket fondit Dega IV.
29. Kartelë Model 2 nr. 1147, në ngarkim të M. K. K., me 2 (dy) fletë. Kartela i përket fondit Dega IV.
30. Kartelë Model 2 nr. 4004, në ngarkim të D. N. K., me 2 (dy) fletë. Kartela i përket fondit Dega IV.
31. Dosje Pune nr. 1806, në ngarkim të Gj. M. M., konkretisht raporti i datës 20.09.1981 me 2 (dy) fletë nga kjo dosje. Niveli i klasifikimit të dokumenteve është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Mirditë.
32. Kartelë Model 2 nr. 2496(1168/1565), në ngarkim të Q. B. M., me 2 (dy) fletë. Kartela i përket fondit Dega IV.
33. Kartelë Model 2 nr. 5995, në ngarkim të B. S. H., me 2 (dy) fletë. Kartela i përket fondit Dega IV.
34. Kartelë Model 2 nr. 1479, në ngarkim të J. P. P., me 2 (dy) fletë. Kartela i përket fondit Dega IV.
35. Kartelë Model 2 nr. 4295, në ngarkim të Z. A. S., me 2 (dy) fletë. Kartela i përket fondit Dega IV.
36. Kartelë Model 2 nr. 3592, në ngarkim të P. N. N., me 2 (dy) fletë. Kartela i përket fondit Dega IV.
37. Kartelë Model 2 nr. 1179, në ngarkim të F. N. L., me 2 (dy) fletë. Kartela i përket fondit Dega IV.
38. Dosja Personale dhe Pune nr. 1425, në ngarkim të N. Sh. T., konkretisht raporti i datës 02.09.1988 me 2 (dy) fletë dhe raport i dates 17.11.1989 me 2 (dy) fletë. Në total janë 5 (pesë) fletë nga kjo dosje. Niveli i klasifikimit të dokumenteve është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Pukë.
39. Kartelë Model 2 nr. 3425, në ngarkim të B. B. D., me 2 (dy) fletë. Kartela i përket fondit Dega IV.
40. Kartelë Model 2 nr. 7972, në ngarkim të A. I. Gj., me 2 (dy) fletë. Kartela i përket fondit Dega IV.
41. Kartelë Model 2 nr. 4076, në ngarkim të S. R. V., me 2 (dy) fletë. Kartela i përket fondit Dega IV.

KRYETARE E KDZH-së
Gentiana Sula

Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendim nr. 25, datë 23.10.2020

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika b), dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika a), c), Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror”, me vendimin nr. 25, datë 23.10.2020, si më poshtë:

Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH

Deklasifikimin e plotë të dosjeve:

1. Fashikull nr. 2652, në ngarkim të F. I. V., me 82 (tetëdhjetë e dy) fletë dhe një zarf. Niveli i klasifikimit të fashikullit është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Të Arratisur.
2. Dosje përpunimi nr. 4767, në ngarkim D. Xh. Ç, me 127 (njëqind e njëzet e shtatë) fletë dhe një zarf me 34 (tridhjetë e katër) fletë, si dhe fashikull personal për të dënuar me 12 (dymbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Vlorë.
3. Dosje formulare nr. 3984 në ngarkim R. M. O (M), me 25 (njëzet e pesë) fletë dhe 1 (një) kartelë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Vlorë.
4. Dosje përpunimi nr. 1537 në ngarkim D. N. L, me 101 (njëqind e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Vlorë.
5. Dosje kërkimi nr. 6168 në ngarkim D. N. L, me 65 (gjashtëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Kosova.
6. Dosje formulare nr. 7426 në ngarkim E. H. B, me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Tiranë.
7. Dosje formulare nr. 224, në ngarkim të R. A. H, me 182 (njëqind e tetëdhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Operativ.
8. Dosje formulare nr. 3393 dhe fashikull i përgjithshëm i bandës së I. V nr. 3393/1 në ngarkim të I. V. Z., me 221 (dyqind e njëzet e një) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Operativ.
9. Dosje formulare nr. 339, në ngarkim të I. S. A., me 115 (njëqind e pesëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Operativ.
10. Dosje formulare nr. 665, në ngarkim të S. I. D., me 71 (shtatëdhjetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Operativ.

11. Dosar me 10 vëllime nr. 1760-1763 me materiale të bandës së A. L., me 1023 (një mijë e njëzet e tre) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Operativ.
12. Dosar me 10 (dhjetë) fashikuj me procesverbale asgjësimi të përpunimeve 1982 – 1991, me 201 (dyqind e një) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dokumenteve është “Tepër Sekret”. Dokumentet i përkasin Fondit Dega e Punëve të Brendshme Përmet.
13. Dosje e problemit të centralizuar “Lenia” nr. 1145, në ngarkim të F. K. P., me 168 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega IV.
14. Proçesverbal i datës 1991 mbi veçimin e dosjes për asgjësim, në ngarkim të Gj. K. M., me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të proçesverbalit është “Sekret”. Proçesverbali i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Shkodër.
15. Proçesverbal i datës 1991 mbi veçimin e dosjes për asgjësim, në ngarkim të A. K. M., me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të proçesverbalit është “Sekret”. Proçesverbali daton në vitin 1991. Proçesverbali i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Shkodër.
16. Proçesverbal nr. 646 Prot., datë 15.06.1978, me 2 (dy) fletë, marrë nga dosja formulare nr. 1136, në ngarkim të H. I. D.. Niveli i klasifikimit të proçesverbalit është “Sekret”. Proçesverbali daton në vitin 1978 dhe i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Kukës.
17. Fondi Drejtoria e II-të, Dosje objekti nr. 131 “Lidhja e Prizrenit” (dega e Franës, Belgjikës, R. F. Gjermanisë, Turqisë dhe SH.B.A-së), 2 volume me 971 (nëntëqind e shtatëdhjetë e një) fletë në total. Niveli i klasifikimit është “Tepër Sekret”.
18. Fondi nr.4, Drejtoria e I, Viti 1973, Dosja nr. 335, “Disa konkluzione mbi një ngjarje të jashtëzakonshme në repartin e riedukimit të armiqve të popullit”, me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit “Sekret”.
19. Fondi nr.4, Drejtoria e I, Viti 1989, Dosja nr. 267, “Për disa komente armiqësore të zhvilluara nga elementët antiparti e lidhjet e tyre me burgun e Burrelit dhe me masë internimi”, me 4 (katër) fletë. Niveli i klasifikimit “Sekret”.
20. Fondi nr.4, Drejtoria e I, Viti 1981, Dosja nr. 183, “Informacion mbi ndjekjen e disa të dhënave për veprimtari të organizuar armiqësore në repartin 321 Burrel me pseudonimin “Ujku” dhe shënimet e bëra nga drejtuesit e ministrisë”, me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit “Sekret”.
21. Fondi nr.4, Drejtoria e I, Viti 1984, Dosja nr. 339, “Informacione të drejtorisë I për veprimtarinë armiqësore të elementit antiparti në burgun e Burrelit dhe në Rrëshen si dhe ridislokimin e këtij elementi e lidhjet e tyre, dërguar KQ të PPS”, me 30 (tridhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit “Sekret”.
22. Fondi nr.4, Drejtoria e I, Viti 1983, Dosja nr. 269, “Raport operativ i drejtorisë I mbi veprimtarinë armiqësore të elementit antiparti në burgun e Burrelit, dërguar KQ të PPSH”, me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit “Sekret”.
23. Fondi nr.4, Drejtoria e I, Viti 1963, Dosja nr. 164, “Relacion dërguar Komitetit Qëndror mbi disa crregullime në punën e radio Tiranës”, me 12 (dymbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit “Tepër Sekret”.
24. Fondi nr.4, Drejtoria e I, Viti 1969, Dosja nr. 116/3, “Informacion dërguar udhëheqësit mbi komente e parullat në lidhje me Kongresin e Shkrimtarve dhe Artistve”, me 6 (gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit “Tepër Sekret”.
25. Fondi nr.4, Drejtoria e I, Viti 1989, Dosja nr. 586, “Miratime dhe refuzime për daljet jashtë shtetit të artistëve të asambleve, grupeve të teatrove, këngëve dhe valleve popullore të

- propozuar nga Komiteti i Kulturës dhe Arteve”, me 88 (tetëdhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit “Sekret”.
26. Fondi nr.6, Drejtorja e III, Viti 1956, Dosja nr. 503, “Relacione dhe të dhëna informative mbi veprimtarinë armiqësore tësore të emigracionit reaksionar shqiptar jashtë shtetit dhe organizatat e tyre “Komiteti Shqipëria e Lirë” dhe “Blloku Independent””, me 37 (tridhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit “Sekret”.
 27. Fondi nr.6, Drejtorja e III, Viti 1957, Dosja nr. 545, “Relacione dhe të dhëna informative nga burimet e zbulimit politik mbi veprimtarinë armiqësore të emigracionit reaksionar shqiptar dhe organizatat e tyre, “Shqipëria e Lirë, e “Blloku Independent” pas riorganizimit të Komitetit Shqipëria e Lirë në tetor 1956”, me 47 (dyzetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit “Tepër Sekret”.
 28. Fondi nr.6, Drejtorja e III, Viti 1960, Dosja nr. 667, “Relacione e të dhëna informative të emigracionit reaksionar në shtetet e perëndimit dhe gjendja e organizatave të tyre , Blloku Independent, Komiteti Shqipëria e Lirë e Partia Agrare.”, me 75 (shtatëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit “Tepër Sekret”.
 29. Dosje formulare nr. 766, në ngarkim të Q. A. H., me 8 vëllime me 1074 (një mijë e shtatëdhjetë e katër) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket Fondi Drejtorja e II – të.
 30. Dosje nr. 4, në ngarkim të R. I. S., me 3 (tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Rezervë të Degës IV.
 31. Dosje formulare nr. 1275, në ngarkim të I. Sh. V., me 377 (treqind e shtatëdhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Të Arratisur.
 32. Dosje formulare nr. 669, në ngarkim të P. N. P., 88 (tetëdhjetë e tetë) dhe Kartelë Model 1, si dhe fashikull personal për të dënuar me 8 (tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Ersekë

KRYETARE E KDZH-së

Gentiana Sula

**VEPRIMTARI TË
AUTORITETIT
PËR INFORMIMIN
MBI
DOKUMENTET E
ISH-SIGURIMIT TË
SHTETIT PËR
PERIUDHËN
SHTATOR-TETOR**



VEPRIMTARI TË AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT PËR PERIU DHËN SHTATOR-TETOR

*Për qëllim të edukimit qytetar, në bazë të Kalendarit të kujtesës dhe në kuadër të informimit, ndërgjegjësimit të shoqërisë, DMSHEQ ka organizuar një sërë aktivitete, të miratuara më herët në Autoritet, duke iu përshtatur kushteve të krijuara nga pandemia Covid 2019, për të cilët është koordinuar infrastruktura përkatëse, janë përgatitur ftesa, programe, shpërndarje dhe informacione e njoftime për shtyp, për komunikim të zgjeruar me partnerët dhe publikun e interesuar.

AIDSSH, takim me Berk në kuadër të përgatitjeve për Dialogun e Tiranës

Më 3 shtator 2020, u zhvilluan takime me qëllim shkëmbim idesh dhe bashkëpunime të ardhshme mes AIDSSH dhe Berk, në kuadër të përgatitjeve për [#Dialogun e Tiranës](#).



AIDSSH, takim me FES në kuadër të projektit të përbashkët “Mendimi politik i së majtës”

Më 17 shtator 2020 Kryetarja e AIDSSH znj. Gentiana Sula, priti në takim përfaqësues të FES në Shqipëri, znj. Stine Klapper dhe znj. Jonida Smaja, në kuadër të projektit të përbashkët “#Mendimi_politik_i_së_majtës”.




AIDSSH në takimin rajonal "Drejt paqes pozitive: Kundër gjuhës së urrejtjes"

Më 21 shtator 2020, në Ditën Ndërkombëtare të Paqes, u zhvillua takimi rajonal "Drejt paqes pozitive: Kundër gjuhës së urrejtjes" bashkëpunim i shoqatës "Udhëtimi i Lirë", dhe organizatës "Youth for Peace". Kryetarja e AIDSSH znj. Gentiana Sula, mbajti fjalën në takim, mbi gjuhën e urrejtjes dhe përpjekjet aktive për paqe duke theksuar se intoleranca, dhuna dhe urrejtja nuk janë mjetet e duhura për ndryshime pozitive.

Znj. Sula theksoi se urrejtja, e shfaqur në forma të ndryshme si: propagandë, censurë, përndjekje, terror, izolim gjithmonë i ka përçarë njerëzit dhe është bërë 'motor' inkurajimi për krimet politike përmes së cilit synohet kontrolli total i shoqërisë. Ndaj, politikat e miratuara për njohjen me padrejtësitë e së kaluarës që sollën izolimin e mendimit dhe shoqërisë, do të sjellin rezultate pozitive dhe një shoqëri të qetë e pa dhunë.

Në vijim kryetarja Sula iu referua situatës në rajon, duke vlerësuar si veprim të domosdoshëm hapjen e dokumenteve sekrete të ish-Jugosllavisë, pasi ky veprim do të nxisë debat konstruktiv dhe do të zbusë gjuhën e urrejtjes mes vendeve të ndryshme të Ballkanit, duke bërë të mundur bashkëpunimin dhe krijimin e dialogut pozitiv mes tyre.

Në përfundim, të gjitha politikat e ndryshme, dialogu dhe çdo përpjekje tjetër për të shmangur gjuhën e urrejtjes, nuk janë gjë tjetër, veçse pohim i shprehjes së Gandit se "paqja nuk është destinacioni, por e gjithë rruga që ne bëjmë për të arritur deri atje".



AIDSSH, pjesë e Task Forcës për kërkimin e eshtrave të shtetasit italian Giuseppe Terrusi

Më 1 tetor 2020 filluan gërmimet në rrethinat e burgut të Burrelit, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit "Për ngritjen e Grupit ndërinstitucional të punës për hartimin dhe zbatimin e masave për kërkimin, identifikimin dhe kthimin në atdhe të eshtrave të shtetasit italian Giuseppe Terrusi", ku AIDSSH është pjesë.



AIDSSH, takim në Institutit të Arkeologjisë, për të zhdukurit në diktaturë

Më 5 tetor 2020, në Institutin e Arkeologjisë pranë ASA u diskutua me drejtorin, z. Luan Përzhita, anëtar i grupit të punës, dhe antropologun, mbi hapat e ardhshëm dhe protokollet përkatëse për kërkimin, identifikimin, gërmimin dhe zhvarrimin e të zhdukurve në diktaturë, me asistencën e ekspertëve të fushës dhe përdorimin e pajisjeve të duhura.

Përcaktimi i rolit të secilit prej aktorëve në proces, mbështetja institucionale dhe mbikëqyrja e të gjitha fazave të punës, nga raportimi, identifikimi deri në verifikimin e viktimitës përmes mostrës së ADN-së, janë detyrim i shoqërisë së sotme për këtë plagë ende të pambyllur të së djeshmes. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit vijon takimet koordinuese në zbatim në ligjit 45/2015 i ndryshuar, neni 22/1, “Bashkëpunimi për identifikimin dhe rikuperimin e trupave të të zhdukurve dhe të të ekzekutuarve, si dhe masat për ruajtjen e vendvarrimeve” dhe urdhrin nr. 150, datë 11.11.2019 të Kryeministrit, “Për ngritjen e Grupit ndërinstitutional të punës për hartimin dhe zbatimin e masave për kërkimin, identifikimin dhe kthimin në atdhe të eshtrave të shtetasit Italian Giuseppe Terrusi”.



AIDSSH, takim në Institutin e Mjekësisë Ligjore për të zhdukurit në diktaturë

Më 7 tetor 2020, në Institutin e Mjekësisë Ligjore u diskutua me drejtorin, z. Bledar Xhemali, mbi hapat e ardhshëm dhe protokollet përkatëse për kërkimin, identifikimin, gjurmimin dhe zhvarrimin e të zhdukurve në diktaturë, me asistencën e ekspertëve të fushës dhe përdorimin e pajisjeve të duhura, nga identifikimi deri në verifikimin e viktimës përmes mostrës së ADN-së.

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit vijoi takimet koordinuese në zbatim të ligjit 45/2015 i ndryshuar, neni 22/1, “Bashkëpunimi për identifikimin dhe rikuperimin e trupave të të zhdukurve dhe të të ekzekutuarve, si dhe masat për ruajtjen e vendvarrimeve” dhe urdhrin nr. 150, datë 11.11.2019 të Kryeministrit, “Për ngritjen e Grupit ndërinstitucional të punës për hartimin dhe zbatimin e masave për kërkimin, identifikimin dhe kthimin në atdhe të eshtrave të shtetasit Italian Giuseppe Terrusi”.



AIDSSH, takime për Dialogët lokalë të Korçës e Maliqit


Më 7 - 8 tetor 2020, AIDSSH zhvilloi takime bashkëpunimi me pushtetin lokal dhe aktorë të fushës së kujtesës, në kuadër të organizimit të Dialogëve të Korçës e Maliqit, për nderimin e personaliteteve të rezistencës, solidaritetit njerëzor dhe përkujtimit të të dënuarve të Maliqit ende të zhdukur...



Informimi për qëllime të kërkimit shkencor

Më 12 tetor 2020, Z. Luan Malltezi, ish-drejtor i Arkivit Qendror të Shtetit dhe Muzeut Historik Kombëtar, tërhoqi dosjen e Veniamin Dashit, mes atyre të përkthyesve e gjuhëtarëve të tjerë, për të cilën kishte aplikuar më herët pranë AIDSSH dhe vizitoi mjediset e institucionit, i shoqëruar nga kryetarja znj. Gentiana Sula.

Aktualisht, AIDSSH po punon për ngritjen e një projekti, në bashkëpunim me partnerë, për profilet biografike të përkthyesve dhe gjuhëtarëve, të përndjekur e dënuar në diktaturë.



AIDSSH, takim me Prokurorin e Përgjithshëm, për të zhdukurit në diktaturë

Më 21 tetor 2020, ekipi i AIDSSH, i përfaqësuar nga Kryetarja, znj. Gentiana Sula, Anëtari z. Simon Mirakaj dhe Sekretari i Përgjithshëm, z. Skënder Vrioni, zhvilloi një takim informues me Prokurorin e Përgjithshëm, z. Olsian Çela dhe përfaqësuesin e departamentit të koordinimit me institucionet e tjera, z. Sokol Stojani.

Ndryshimet në ligjin 45/2015, nisma e Kryeministrit dhe grupi ndërinstytucional i punës i ngritur për zhvarrimet dhe identifikimin e të zhdukurve në Burrel, koordinimi mes institucioneve dhe rolet përkatëse ishin pjesë e diskutimeve. Po ashtu, shfrytëzimi i mundësive për ta çuar punën përpara për një udhëzim të Prokurorisë sa i takon kësaj çështjeje dhe krijimit të grupeve të përbashkëta të punës për qartësimin e fatit të të zhdukurve.

Në zbatim në ligjit 45/2015 i ndryshuar, neni 22/1, “Bashkëpunimi për identifikimin dhe rikuperimin e trupave të të zhdukurve dhe të të ekzekutuarve, si dhe masat për ruajtjen e vendvarrimeve”, AIDSSH vijoi takimet dhe kontaktet me institucionet dhe organizatat brenda dhe jashtë vendit për hartimin dhe ndjekjen e protokolleve të përshtatshme për identifikimin, gërmimin dhe zhvarrimin e të zhdukurve në diktaturë, në vendekzekutimet e raportuara.



Nënshkruhet marrëveshje bashkëpunimi mes AIDSSH dhe Shoqatës “Tirana”

Më 22 tetor 2020, u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit midis Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Shoqatës “Tirana”, mes znj. Gentiana Sula, Kryetare e Autoritetit dhe z. Arben Tafaj, Kryetar i Shoqatës.

Ceremonia u organizua në mjediset e shtëpisë së familjes Begeja në Rrugën e Dibrës, në praninë e përfaqësuesve të shumtë të komunitetit tiranas, familjeve të vjetra e mirënjohura autoktone, trupit diplomatik dhe medias.

Objekt i marrëveshjes është institucionalizimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit të ndërsjellë në fushën e kujtesës gjatë rishqyrtimit historik të veprimtarisë së Sigurimit të Shtetit, nëpërmjet aktiviteteve të përbashkëta sensibilizuese që hedhin dritë në historinë gjysmëshekullore të Tiranës kryeqytet në diktaturë, studimit e hulumtimit në dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit; mbledhjes së dëshmimeve të individëve dhe familjarëve që i përjetuan ndryshimet në vetë të parë; rindërtimit të një narrative të re, pas përqsjes e grumbullimit të të dhënave për figura e personalitete të njohur të Tiranës, të survejuar, përndjekur e të përbaltur në diktaturë, si dhe evidentimit, përcaktimit dhe ruajtjes së vendeve të kujtesës, emërimit të tyre, vënies së pllakateve, tabelave, ngritjes së memorialeve për nderimin e viktimave të diktaturës komuniste, për të rritur ndërgjegjësimin në brezat e rinj, nëpërmjet edukimit qytetar dhe mbështetjes së kërkimit shkencor. “Në këtë vit të njëqindtë të Tiranës kryeqytet, bashkëpunimi me komunitetin dhe shoqatat aktive konkretizohet me marrëveshjen me Shoqatën “Tirana”, për zbardhjen e dokumenteve dhe ngjarjeve historike për ndërtimin e Dialogut të Tiranës, me historitë e popullsisë autoktone, asaj të vendosur në Tiranë dhe ngjarjet e rëndësishme historike që u zhvilluan në kryeqytet. Marrëveshja synon të bashkërendojë punën e Autoritetit dhe të studiuesve që bashkëpunojnë me Shoqatën “Tirana”, duke kontribuar në kalendarin e ndryshimeve demokratike dhe 100 vjetorin e Tiranës. Të dy institucionet do të organizojnë punën në funksion të dialogut për demokracinë, bazuar në materialet arkivore mbi rolin dhe funksionimin e ish-Sigurimit të Shtetit në ngjarje të rëndësishme të historisë sonë,” u shpreh Kryetarja e Autoritetit, znj. Sula.

“Shtëpia e familjes Begeja është vetëm një ndër hapësirat tiranase që me vendosjen e regjimit komunist dëshmoi histori të dhunës, uzurpimit, tjetërsimit dhe shkeljes së të drejtave të njeriut. Bashkëpunimin me AIDSSH, Shoqata “Tirana” e sheh me vlerë për zberthimin e asaj historie që mbetet e panjohur jo vetëm për tiranasit, por për të gjithë shqiptarët. Zbardhja e së shkuarës, studimi i saj, prezantimi i profileve dhe ekspozitave, publikimeve mbi të kaluarën gjysmëshekullore të kryeqytetit, në bashkëpunim me studiues, komunitetin dhe institucionet është detyrim ndaj shoqërisë së sotme dhe të ardhmes sonë”, theksoi z. Arben Tafaj, kryetar i Shoqatës "Tirana"

AIDSSH dhe Shoqata “Tirana” do të punojnë për hartimin e planeve të përbashkëta për aktivitete të kalendarit të kujtesës, nisma për edukimin qytetar, ekspozita dokumentare dhe të profileve, tryeza pune, publikime, etj. Bashkëpunimi synon të konsolidojë punën për njohjen e së shkuarës, në funksion të transparencës dhe komunikimit me qytetarët.



Nënshkruhet kontrata për rikonstruksionin e ndërtesës së AIDSSH

Më 23 tetor 2020, u nënshkrua kontrata për rikonstruksionin e ndërtesës së AIDSSH. Afati i parashikuar i punimeve për rikonstruksionin e ndërtesës është 90 ditë, plan pune i marrë përsipër nga fituesit (joint-venture mes OB KONSTRUKSION shpk dhe ED KONSTRUKSION SHPK) që nënshkruan kontratën me Sekretarin e Përgjithshëm të AIDSSH, z. Skënder Vrioni.

Fituesi u përzgjedh pas një procesi verifikues të 20 subjekteve aplikuese, punë voluminoze e kryer nga komisioni përkatës i AIDSSH, dhe do të realizojë rikonstruksionin e ndërtesës, në vijim të punimeve të deritanishme në arkiv.

AIDSSH ka përfituar një grant nga Qeveria Suedeze për krijimin e kushteve dhe standardeve bashkëkohore të punës, përfshirë shërbimet e integruara TIK.

Marrëveshja ndërmjet dy palëve SIDA (Ambasada Suedeze) dhe AIDSSH u nënshkrua në gusht të 2019 dhe deri në këtë pikë janë ndjekur të gjitha procedurat ligjore e financiare për implementimin e fondeve sipas projektit të rikonstruksionit të ndërtesës, të dakordësuar me donatorin.



Fillon rikonstruksioni i ndërtesës së institucionit

Më 26 tetor 2020 AIDSSH u dorëzi kantierin e punimeve kompanive fituese (joint-venture e OB KONSTRUKSION shpk dhe ED KONSTRUKSION SHPK) të cilat, sipas afatit të parashikuar të punimeve do të rikonstruktojnë ndërtesën e institucionit. Proceset e punës do të ndiqen në vijim, për të mundësuar kushte të përshtatshme për arkivin, stafin, individët dhe studiuesit e interesuar. Punimet mundësohen nga granti i përfituar nga Qeveria Suedeze, për krijimin e kushteve dhe standardeve bashkëkohore të punës, përfshirë shërbimet e integruara TIK.




Takimi i dytë i komitetit drejtues të projektit të rikonstruksionit të ndërtesës së AIDSSH

Më 29 tetor 2020, u zhvillua takimi i dytë i Komitetit Drejtues të Projektit të rikonstruksionit të ndërtesës së AIDSSH dhe shërbimeve TIK për krijimin e një arkive moderne, i mbështetur nga Qeveria Suedeze, me praninë e anëtarëve të Komitetit Drejtues dhe Sekretariatit Teknik të AIDSSH, i përfshirë në zbatimin e projektit.

Takimi trajtoi ecurinë e projektit për periudhën qershor-shtator 2020, aktivitetet (prokurimet) e kryera, rezultatet e pritshme dhe realizimin e tyre, problematikat e evidentuara dhe masat e marra për zgjidhje. Po ashtu, u bë parashikimi i aktiviteteve deri në dhjetor 2020.

Përfundimi me sukses i procedurave të prokurimit dhe lidhja e kontratës për rikonstruksionin e ndërtesës së AIDSSH-së, sikurse vendosja e rafteve në arkivin e rikonstruktuar, përmbyllin një fazë të rëndësishme që do të pasohet nga punimet në ndërtesë gjatë muajve të ardhshëm për krijimin e kushteve të përshtatshme të punës për shërbimin dhe komunikimin me qytetarët për informim, hulumtim e njohje me të shkuarën.



NJOHJA NXIT STUDIMIN

Dokumente dhe materiale arkivore të AIDSSH janë vënë në dispozicion të qytetarëve, familjarëve të të dënuarve politikë, studiuesve dhe gazetarëve, sipas kërkesës. Hulumtimi në materiale arkivore ka prodhuar artikuj shkencorë, mediatikë, duke inkurajuar dialog me universitetet, akademikët, komunitetet vendore, të mbijetuarit e familjarët e tyre, mediat dhe publikun e gjerë.



➤ **Deputetët opozitarë përballë ndërtimit të “shtetit të diktaturës së proletariatit”**

Prof. As. Dr. Sonila Boçi

Prof. Dr. Hamit Kaba

Studimi u përgatit në kuadër të aktivitetit “Reflektim për totalitarizmin”, në nderim të deputetëve, në 70-vjetorin e ekzekutimit të tyre.

Heqja e mandatit, arrestimi, dënimi dhe ekzekutimi i një grupi deputetësh të Kuvendit Popullor, në vitin 1947, vetëm një vit pasi ky kishte marrë mandatin për të ushtruar veprimtarinë e tij, është një nga ngjarjet më tronditëse të historisë së komunizmit në Shqipëri. Ajo dëshmoi vullnetin e drejtuesve më të lartë të PKSH-së për të mos lejuar asnjë hapësirë lirie në vend. Si e tillë është një nga gurët kilometrikë në procesin e instalimit të diktaturës së proletariatit. Shumë është folur dhe shkruar për këtë ngjarje, por ende nuk mund të thuash se historia e tyre e trishtë është zbardhur plotësisht. Qëllimi i këtij artikulli është të përpiqet të hedhë dritë mbi rrugëtimin e këtyre personaliteteve, që nga përfshirja e tyre në listat e përfaqësuesve të Frontit Demokratik, në Asamblenë Kushtetuese, deri në dënimin e tyre. Ai, gjithashtu, do të përpiqet të shpjegojë kontekstin historik të brendshëm dhe të jashtëm që ndikoi në arrestimin dhe dënimin e deputetëve të Kuvendit Popullor.

Libri mund të lexohet në versionin online në faqen issue te AIDSSH, në linkun [Deputetët për Deputetët VOL 1 by AIDSSH - issue](#)

Fajtorë pa faj: Dënimi i inxhinierëve të kënetës së Maliqit, pjesë e justifikimeve për dështimet e regjimit komunist

Prof. As. Dr. Sonila Boçi

Studimi u përgatit në kuadër të aktivitetit përkujtimor “E vërteta për inxhinierët e Kënetës së Maliqit”, hapjes dhe botimit të dosjes së tyre nga AIDSSH.

- Situata politike në Shqipëri gjatë vitit 1946

Viti 1946 shënoi një moment kthese në historinë e Shqipërisë, por edhe më gjerë. Kontradiktat ndërmjet Aleatëve të Mëdhenj, SHBA-së, Britanisë së Madhe, nga njëra anë, dhe Bashkimit Sovjetik, nga ana tjetër, po bëheshin gjithnjë e më të dukshme. Lufta ideologjike, shtrirja e zonave të influencës dhe imponimi i sistemeve të qeverisjes, kishte bërë që në Europë të binte ajo, që Willson Churchill-i do ta konsideronte “Perdja e Hekurt”. Kjo situatë do të ndikonte drejtpërdrejt edhe në një vend të vogël si Shqipëria.

Sa i takon politikës së brendshme në Shqipëri, fitorja në zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese i dha një lloj qetësie udhëheqjes komuniste shqiptare. Shpallja e Republikës Popullore më 11 janar 1946 dhe miratimi i Statutit të saj më 14 mars të po atij viti, sanksionuan juridikisht programin e Frontit, por mandati popullor i “pushtetit popullor” mbetej i diskutueshëm për shkak të paketës ligjore me të cilën u organizuan zgjedhjet.

Në fillim e vitit 1946, në aspektin politik, komunistët shqiptarë u treguan të ashpër dhe të prerë në krijimin e organeve politike-administrative, gjyqësore dhe ushtarake të shtetit shqiptar të kontrolluara nga PKSH-ja, që vazhdonte të qëndronte në gjysmë ilegalitet brenda Frontit Demokratik. Në fushën ekonomike, u ndërmorën hapa për krijimin dhe forcimin e sektorit shtetëror në ekonomi, nëpërmjet shpronësimeve të të huajve dhe atyre që u cilësuan bashkëpunëtorë të pushtuesit. Ekonomia po organizohej sipas parimit të “centralizimit ekonomik”, megjithëse ende ekzistonte prona private, sigurisht nën kontrollin e rreptë shtetëror. Regjimi miratoi dhe filloi të zbatonte një sërë projektesh ambicioze, si: ndërtime rrugësh, hekurudhash, tharje kënetash, të cilat kërkonin burime të mëdha financiare, por edhe mobilizim të gjerë njerëzor. Regjimi komunist krijoi në këtë mënyrë shtresën e vet mbështetëse politike dhe ekonomike.

Më 21 shkurt 1946 u mbledh Plenumi V i KQ të PKSH-së, ku u deklarua se në Shqipëri po vendosej “një diktaturë demokratike revolucionare e punëtorëve dhe e fshatarëve me Partinë Komuniste në krye”.

Libri mund të lexohet në versionin online në faqen issue te AIDSSH, në linkun [E vërteta e inxhinierëve të Kënetës së Maliqit by AIDSSH - issue](#)

Spiunë dhe sabotatorë: Sakrifikimi i inxhinierëve të Maliqit dhe akuza për mision agjenturor amerikan gjatë regjimit komunist shqiptar

Msc. Kejsi Ziu

Studimi u përgatit në kuadër të konferencës ndërkombëtare shkencore të AIDSSH me partnerë “Të mohuar nga regjimi: burgjet, sistemi i internim-dëbimeve dhe puna e detyruar në Shqipëri, 1944-1990”.

Që në fillimet e ekzistencës së tij, regjimi komunist në Shqipëri u karakterizua nga shkelje të së drejtave më themelore të njeriut si mjet i vazhdueshëm pune duke nisur që nga eliminimi i pronës private, te përdorimi i punës së detyruar, trajtimi çnjerëzor e poshtëruës dhe burgimi, vrasja e kundërshtarëve apo individëve të tjerë të kapur në shakullinë shkatërruese të agresionit komunist. Një shembull konkret i kësaj politike thellësisht çnjerëzore e antishqiptare është arrestimi i grupit të inxhinierëve të ngarkuar me detyrën e tharjes së Kënetës së Maliqit, të akuzuar nga regjimi si sabotatorë dhe bashkëpunëtorë të spiunazhit amerikan në Shqipëri.

Disa nga çështjet për diskutim janë: A ishte grupi teknik realisht sabotues, pra, “agjent i misionit amerikan në Shqipëri” apo kjo ishte një akuzë e përdorur nga regjimi për të eliminuar ndikimin e SHBA-së në Shqipëri? A e përdori Sigurimi i Shtetit arrestimin e grupit të inxhinierëve të Maliqit për të larguar ndikimin e frymës perëndimore demokratike nga Shqipëria, dhe për ta kthyer Shqipërinë në një vend pa asnjë lloj transparence demokratike dhe llogaridhënieje për veprimet qeverisëse? Cilat ishin akuza dhe e vërteta e inxhinierit më të ri në moshë, Kujtim Beqiri? Cili ishte pozicioni dhe roli i Fultzit në Shqipëri?

Libri mund të lexohet në versionin online në faqen issue te AIDSSH, në linkun: [Të mohuar nga regjimi, pjesa 1 by AIDSSH - issue](#)

PROFILE DHE RRËFIME PËR TË ZHDUKUR NË DIKTATURË

Rrëfimet e mëposhtme janë përfshirë në ekspozitën “E shkuara e pakryer” të zhdukur në diktaturë, bashkëpunim i AIDSSH me ICMP, IIPP dhe gazetaren Fatmira Nikolli, mbështetur nga Fondacioni Konrad Adenauer Tiranë.

Në këtë buletin do të njiheni me një pjesë të profileve të paraqitura në ekspozitë.



7 varret e një familjeje

9 shtator 1946

“Mbramë, në ora dy mbas mesit të natës u zbulue në seksion se ku ndodhet Jup Kazazi. Në rrethimin që i bëmë shtëpisë dhe mbasi si e pa se neve e gjetëm bodrumin ku ishte mëshefur dhe s’kishte shpëtim, vrau vehten. Këtu popullarizohet se e vramë neve (në dokument nënvizohet me shkrim dore “Mirë”, që nënkupton se e miratojnë). Kemi gjetur disa dokumenta, por ma të randësishmet do t’ua dërgojmë. Zoi Themeli”.

Dokumenti i mësipërm tregon qëndrimin zyrtar që mbajti regjimi komunist për vdekjen e Jup Kazazit, ndër organizatorët e kryengritjes së Postribës, e para antikomuniste në Europën e Lindjes, që po niste instalimin e perdes së hekurt.

Më 9 shtator 1946, duke synuar që me “Postribën” të lironin të burgosurit e të merrnin institucionet, shpërtheu para kohe ajo që sot njihet si Kryengritja e Postribës, me disa qindra kundërshtarë të regjimit, mes të cilëve, vëllezërit Kazazi. Duke qenë më të paktë në numër dhe me armë, kryengritësit dështuan, ndërsa pushteti u bë më i egër duke arrestuar mbi 1200 veta, hapur 11 burgje të përkohshme e vranë dhjetëra të tjerë. Jupi shpëtoi, por u detyrua të fshihej dhe u strehua te daja i tij.

Me 17 shtator, shtëpia ku fshihej u zbulua, pasi u torturua një dëshmitar që kishte dijeni. Duke mos dashur të binte i gjallë në duart e komunistëve, ai thirri “Rrnoftë Shqipëria. Nuk i dorzohem klyshëve t’Stalinit” dhe vrau veten. Ekzekutorët futën në shtëpi të kontrollonin të vdekurin, nipin 16-vjeçar, Ahmet Kopliku.

I biri i Jupit, Hamza Kazazi thotë se të atin e masakruan edhe për së vdekuri, kënduan e hodhën valle dhe e ekspozuan në qytet.

Pas ngjarjes, 7 anëtarë dhe të afërm të familjes Kazazi u ekzekutuan, vranë veten ose vdiqën, ndërsa dhjetëra të tjerë u internuan. Trupat e të vranëve nuk iu kthyen kurrë familjeve.

73 vite më pas, ende nuk ndihen varret e tyre.

I biri i Jupit, Hamza Kazazi, pas 1990-s ka nisur kërkimet për eshtrat e të afërmeve. Ndërsa kërkon 7 të zhdukurit e tij prej 30 vitesh, ka arritur të kuptojë se “procesverbalet baheshin të rrejshme”.

Kryqe pa varre

I Lumi Dom Shtjefën Kurti është vetëm një prej klerikëve të krishterë që janë ekzekutuar në komunizëm dhe ende pa varr. I ardhur nga Kosova më 1930, në shtator 1943, ai lajmëronte Arqipeshkvinë se po pagëzonte hebrenj, me gjasë për t’i shpëtuar nga nazistët, sepse me pagëzimin merrnin emra të rinj e pasaporta shqiptare. U arrestua për herë të parë më 28 tetor 1946 për agjitacion e propagandë dhe u dënua me 20 vjet burg. Ai kishte refuzuar të shkëputej nga Vatikani dhe e çuan në Burrel, por nuk u dorëzua as mes torturave. E çuan të hapte varrin e tij, por nuk e pranoi akuzën. E kthyen në qeli, ku natën e Krishtlindjeve dëgjohej të thoshte meshën, i përlotur. Dikur e liruan nga burgu. Kishat ishin mbyllur dhe e dërguan në Gurrëz (Milot), ku e lanë të punonte magazinier në kooperativë. U arrestua përsëri më 11 qershor 1970.

Gjyqi për të zhvillohej në Kishën e Zojës së Këshillit të Mirë në Gurrëz, godinë e kthyer në vatër kulture pas prishjes së vendimit të diktatorit për të ndaluar besimin fetar. U dënua me vdekje “in odium fidei”, pse pagëzoi ilegalisht një fëmijë. Një ditë të trishtë vjeshte, 20 tetorin e vitit 1971, ai u mor nga qelia dhe u vu para togës së pushkatimit. Kur e pyetën nëse i vinte keq për jetën, tha: “Më vjen keq që po ma merrni ju”. Akuza zyrtare kishte qenë sabotim. Por koha do të hidhte dritë.

Në vitin 2011, nipi i tij, Nikolin Kurti, ka mundur të takojë prokurorin që kërkoi dënimin, Hajredin Fuga, dhe gjykatësin që mori vendimin, Jani Vasili. Të dy i kanë lënë një ndjesë të shkruar me dorë, për çfarë ka ndodhur me meshtarin. Nikolin Kurti i ka botuar letrat në janar 2019, duke respektuar dëshirën e Fugës e Vasilit që letrat të publikoheshin pas vdekjes së tyre. Në letrën e tij të ndjesës, prokurori Fuga ka thënë se çështja për Dom Shtjefnin pati nisur me pak drithë të vjedhur në kooperativë, derisa në të përfshinë edhe emrin e priftit.

Studiuesi Kastriot Dervishi ka publikuar së fundmi procesverbalin mbi “ekzekutimin e Shtjefën Jak Kurtit”, ku thuhet se “mbas fjalës së fundit u krye ekzekutimi dhe mbasi u konstatua nga mjeku Asim Ylli se kishte vdekur, u veprua sipas autorizimit përkatës, duke iu dhënë rezultati Dr. Asim Yllit çka nënkupton që trupi i pajetë i është dhënë njërit prej mjekëve që rezulton edhe në raste të tjera që ka tërhequr trupa të pajetë të dënuarish për nevoja të Fakultetit të Mjekësisë, në mësimin e lëndës së anatomisë.

Legjenda e qershisë

Giuseppe Terrusi

Ishte njëherë e një kohë, një pemë qershie që lulëzonte çdo pranverë në rrethinën pranë Burgut të Burrelit. Ata që e shihnin, thoshin se lulet e saj bien mbi tokën ku prehen eshtra të dënuarish pa faj. Sa herë çelnin lulet, të burgosurit e shpëtuar gjallë luteshin për të vdekurit dhe admironin qershinë që lulëzonte vetëm për ta. Është pothuaj legjendë ajo pemë, që sot nuk është më. Të burgosur politikë që e kanë kaluar një pjesë të jetës në atë burg thoshin se nën rrënjët e saj prehej edhe një bankier italian, Giuseppe Terrusi.

Ai kishte ardhur në Shqipëri në prill 1926, kishte punuar në bankën e Gjirokastrës, më pas drejtor i bankës së Vlorës. Dëshmitë e tregojnë tërësisht të papolitizuar.

Më 1945 arrestohet nga regjimi komunist që po instalohej. E akuzojnë se ua ka dorëzuar me dëshirë bankën gjermanëve, ndonëse dëshmitë tregojnë të kundërtën. Është baba i një djali, është martuar me një italiane që e ka njohur në Shqipëri dhe është kunati i një sportisti në zë që ka përfaqësuar Shqipërinë. Aurelia Poselli, duke shfrytëzuar njohjen e kahershme, shkon në Komitetin Qendror të takojë Enver Hoxhën për t'i kërkuar t'i falë të shoqin, por ai nuk e pret. Janë vitet 1948-1949. Giuseppe Terrusi, nga Vlora është dërguar në burgun e Burrelit. Familja e tij, djali dhe gruaja riatdhesohen në Itali, ndërsa ai mbetet i vetëm në burgjet shqiptare.

Giuseppe vdes në burgun e Burrelit më 2 mars 1952. Thuhet se u varros pranë pemës së qershisë ku varroseshin të burgosurit deri më 1955.

Që nga viti 1993, i biri, Aldo Renato Terrusi, që kujton të atin si një burrë që e ka parë vetëm një herë në burg, ka ardhur më shumë se 10 herë në Shqipëri. Ka vetëm një peng, të gjejë eshtrat e të atit që t'i çojë të prehen pranë eshtrave të së ëmës, siç qe amaneti i saj.

Ende nuk ka mundur t'i gjejë, për shkak të lejes së munguar për të gërmuar në Burrel. Kujton se në 2012-n ka vajtur në burgun e Burrelit dhe punonjës të administratës shqiptare debatuan para tij për çështje teknike, por nuk e lanë të merrte lopatën në dorë.

“Qershia është bërë objekt legjendë, sepse njerëzit varroseshin aty rrotull. Legjenda thotë se kjo qershia rritej nga gjaku i burgosurve të varrosur”.

Fate të trishta

14 tetor

Dy litarë për inxhinierin Kujtim Beqiri

Një vlonjat 32-vjeçar, ish-nxënës i Harry Fultz-it, që ka kryer me medalje të artë Inxhinierinë Civile në Vjenë, ka përfunduar piketimin e tharjes së Kënetës së Maliqit dhe pret të nisë zbatimin e punës. Është i martuar dhe është bërë baba kur, 6 nëntorin e vitit 1946, i vihen prangat në duar. Në korrik, katër muaj më parë ishte emëruar drejtor i punimeve.

Dy ditë më vonë, ai dhe miqtë e tij, të huaj e shqiptarë të ardhur nga jashtë, nxirren në gjyqin e improvizuar politik. Shqyrtimi i dokumenteve nga studiuesit ka treguar se dosjet hetimore-gjyqësore të këtyre proceseve janë tërësisht të manipuluar nga regjimi, sepse janë marrë e zhvilluar në kushtet më të rënda të torturës psikike dhe fizike.

Vendimi i gjyqit shpallet më 19 nëntor, 13 ditë pas arrestimit dhe më datë 21, me damkën “sabotatorë të Maliqit”, ai dhe kolegët transferohen nga qelitë e Tiranës për në Korçë, për të qenë sa më afër Kënetës së Maliqit. Rrugës, Beqiri ia dha paratë që kishte oficerit shoqërues, që t'i blinte një paketë cigare. Nuk iu kthye kurrë kusuri, si për t'i thënë që në botën tjetër nuk do t'i duheshin.

Vendimi i gjyqit ishte të mos u falej jeta. Për Kujtim Beqirin e Abdyl Sharrën u vendos varja në litar. Më datë 22 nëntor 1946 u vendos të kryhej ekzekutimi në Maliq. Beqirin e vunë në litar, i hoqën stolin dhe po prisnin të jepte shpirt, kur e panë të ishte ende gjallë. Iu afruan dhe panë se litari kishte kapur jakën e palltos së inxhinierit, por jetën që ia fali litari, nuk ia falën ekzekutuesit. Fjalët e tij të fundit ishin: “Historia do ta tregojë se unë po dënohem e ekzekutohem pa faj”. Këneta e Maliqit u tha sipas piketimit të bërë nga Kujtim Beqiri, sepse as inxhinierët rusë që u morën për piketime të reja që do ta fajësonin të ndjerin, nuk i lëvizën vendimet e tij. Tharja nuk mund të bëhej ndryshe.

Atë natë jeta e tij u fik, por trupi i tij ende nuk ka gjetur paqe. I biri, Kadri Beqiri, prej 73 vitesh do të dijë ku janë eshtrat e babait.

«I kemi kërkuar shumë eshtrat e babait në Maliq por, mjerisht, atje nuk kishte eshtra. Gjatë gërmimeve gjetëm vetëm një dorë njeriu, të cilën e futëm në arkivolin e vogël, sa për të pasur një varr të tij!».

Emri mbi metal

“Kam me vete një teneqe. Kur t’me çojnë me m’pushkatu buzë Kirit, do ta lidhi për kambë e aty do të shkruiej emnin tem, kshu qi do ta kesh ma të lehtë me m’gjetë”- Mark Shllaku.

Mësuesi i malësive të Pukës e Shkodrës, i dashuruar me pikturën dhe poezinë, aktor e sufler në Teatrin “Migjeni”, Mark Shllaku “takohet” me të bijën, Julin, vetëm në copa letrash. Dikur, ai i ka mësuar përmendsh “Lahutën e Malcis”. Sot, ajo i prek letrat e holla të duhanit “Ylli i kuq”, duke dashur të takojë përmes tyre mollëzat e gishtave të babës, si atëherë, kur ajo ishte krejt e vogël e ai, krejt i gjallë. Kanë kaluar 70 vjet, ajo është krejt e madhe, e ai, krejt i humbun. Fjalët janë po ato, amaneti po ai. I paçuar në vend. “Baba ishte i butë shumë. Na i plotësonte të tana dëshirat. Na pat ba edhe kafaz me lepuj, që të luejshim me ta. Na merrte në shkolla verore dhe ne mezi pritshim me ardhë ai në shpi,”- thotë Juli me sytë e ujtë.

Një ditë të shtatorit të 1948-s, Mark Shllaku u nis për në shkollë. Mëngjesin e asaj dite nuk e dinte se nuk do të kthehej më kurrë në shtëpi, as i gjallë, as i vdekur. E arrestuan si organizator i celulës së Partisë Socialdemokrate në Shkodër. I vëllai ishte arratisur dhe i ati i Markut ishte internuar në Tepelenë. Pas 11 muajsh hetuesi, më 25 gusht 1949, Gjykata Ushtarake në Shkodër vendosi ta dënonte me vdekje, me pushkatim. E bija ishte atëherë vetëm 8 vjeçe. Sapo kishte mësuar të shkruante e të lexonte kur iu drejtua kryetarit të Degës së Brendshme në Shkodër. “Ai ishte në një nga kto shpitë e bukura të konfiskuara. Më çoi mama der’ te dera e më tha si me u sjellë. Hyna në një sallon të madh. Iu prezantova dhe iu luta për një takim me babën. Ai më dha një copë letër të firmosme”, kujton Juli. Atë ditë e pa babën përmes hekurave. “Kena shku me mamën dhe jena taku. Baba tha që kam shkru disa letra e i kam futë në dyshek, që ta merrshim. Tha se kishte ba një cop’ metalike, teneqe. ‘Kur t’me çojnë me m’pushkatu buzë Kirit, do ta lidhi për kambë. Kam shkru emnin tem në të, kshu qi do ta kesh ma të lehtë me m’gjetë. Mue më tha: Mos u mërzitni dhe mësoni! Te shkolla e kishte hallin,”- kujton Juli. Mark Shllaku e kishte ditur mirë se trupat e të pushkatuarve ishin zhdukur.

Mes ditarëve të shkollës, mësuesi ka lënë letra me poezi. Është e vetmja fletore që i ka shpëtuar kontrolleve të Sigurimit, pas arrestimit. “Kanë mendu që është fletore e imja”, thotë Juli për shënimet e babës. I hap me radhë dhe lexon poezitë, viti 1946, viti 1947. Mes tyre shquhet poezia “Çinarët”, kushtuar vendit ku pushkatoheshin të dënuarit e komunizmit, pas varrezave të Rrmajit. Vargjet e poezisë së tij pothuaj e përshkruajnë atë që ndodhte netëve pranë dy çinarëve, çka sot na tregon se Marku e dinte se qyteti ishte nën pushtetin e frikës, e se ai mund të ishte edhe fati i tij.

“Në këto shekuj ke kalue,
T’mira, t’kqija mjaft ke pa,
Ktu janë vjerrë e pushkatue
Rrajët e tua ngjak janë la.
Ti nuk fole, gjja s’tregove

Ndër rrajë tuja i ke ngujue
Gemat e tu gjithnjë zgjanove
Banorët e tu n'hije me i mbulue.
Ke hesht mjaft, çinar i mjerë,
Be të lshojnë nanat tuj kja,
Çile gojën, fol njiherë,
Kur ma tepër ti ke pa”.

Poezia nuk ka datë, por fletë të ngjashme me të njëjtin shkrim kanë shënimin: Vrakë, 20 prill 1947.

Kur pas ekzekutimit e shoqja, Angjja, mundi të merrte sendet personale nga hetuesi, në dyshek gjeti një letër të mbrame. Letra i drejtohet Angjes, gruas që deshi, vajzës me të cilën qe njohur në moshë të re, dashuruar e martuar shpejt, sikur ta dinte se nuk kishte shumë kohë. Ai ishte vetëm 22 vjeç kur u bë baba.

Në letrat e duhanit të kohës, Marku që pret të vdesë kujtohet të shënojë borxhet për shtëpinë që patën ndërtuar bashkë dhe lë amanetet. Pothuaj me lutje kërkon të ketë një varr. Nga dëshmitë e lëna me shkrim, i dënuari ndihet të jetë krejt i vrarë, ende pa e qëlluar.

“E dashtuna Angje!

Jam lidh kamsh e duersh. Edhe pak orë me kanë mbet me jetue. Mendjen e kam te ti e fëmija që nuk mujta me ju gëzue. Tashti më kanë pikëllue shumë fytyrat tuaja që më dalin parasysh e s'më lanë me dekë... banu e fortë...”

Pas ekzekutimit, Angjja, ndihmësmjete në zë në Shkodër, paguan një burrë që të kërkojë trupin e të shoqit. E kërkojnë në Kir pranë çinarëve, por nuk e gjejnë. Regjimi nuk jepte të dhëna e, prej 70 vitesh, familja e tij kërkon të çojë në vend amanetin e Markut, por ende nuk e di ku prehet trupi i tij.

Pas 1990-s, Juli me të shoqin kanë pyetur ish-hetues të kohës. Dëshmi të pakonfirmuara përmendin malin e Rrencit, në një natë me shi dhe një varr të cekët...





AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

Adresa
Garda e Republikës, Rr. "Ibrahim Rugova", Tiranë
www.autoritetidosjeve.gov.al